

SPECIFIKIME TEKNIKE

OBJEKTI : MIREMBAJTJE E OBJEKTEVE NDERTIMORE BASHKIA MALIQ

Nr 1-A Riparim kornize b/a me çimento te bardhe me gjeresi 11-13 cm

Ne kete çmim parashikohet teresia e shpenzimeve qe nevojiten per realizimin e 1 ml kornize . Ne çmim futet puna e kryer per prishjen e pjeseve te demtuara,pastrimi i mbeturinave,vlera e materialeve dhe puna e punetorit.

Nr 1- I B Prishje suvaje

Ne kete çmim parashikohet teresia e shpenzimeve qe nevojiten per prishjen e 1 m2 suvaje te demtuar.Ne çmim perfshihet puna e punetorit dhe ngritja e skelave ne lartesine mbi 8 m.

Nr 2- I B Çukitje suvaje

Ne kete çmim parashikohet teresia e shpenzimeve qe nevojiten per çukitjen e 1 m2 suvaje ekzistuese.Ne çmim perfshihet puna e punetorit dhe ngritja e skelave ne lartesine mbi 8 m.

Nr 3 – I B Trasport materiale ndertimi,dheu me auto dei ne 6 km

Ne kete çmim parashikohet teresia e shpenzimeve qe nevojiten transportin e 1 m3 materiale ndertimi deri ne destinacionin e percaktuar nga Investitori, jo me larg se 6 km.

Nr 1- II B Suva e zakonshme fasade mur tulle lartesia mbi 8 m

Ne kete çmim perfshihen materialet,transporti dhe skelaria qe nevojiten per realizimin e 1 m2 suvaje mur tulle ne lartesine mbi 8 m.Suvatimi i realizuar nga nje shtrese me trashesi 2 cm llaci bastard m_25 dozim per m2 rere e lare m3 0.005 m3, llac bastard m3 0.03 , cimento 400 7.7kg , uje e aplikuar ne baze te udhezimeve te pergatitura ne mure dhe e lemuar me mistri e berdaf, duke perfshire dhe cdo sherbim tjeter.

Nr 2- II B Suvatim me fino fasade

Ne kete çmim perfshihen puna e punetorit,blerja e materialit,transporti dhe vendosja e skelave qe nevojiten per 1 m2 suva te realizuar me fino.Suvaja me fino duhet te siguroje nje siperfaqe uniforme e nje cilesie te larte duke parashikuar te gjitha kushtet teknike.

Nr 3-II B Suva xokoli me granil e çimento te zakonshme me spruco.

Ne kete çmim perfshihet materialet qe nevojiten per te bere 1m2 suva xokoli. Materialet si rere e lare lavatrice 0,005 m3 , çimento 32.5 N 6.6 kg, gelqere qull 3.1 kg, llaç i perzier 0.025 m3 dhe granil 0.008m3.Ne çmim perfshihet puna e punetorit dhe tarsporti materialeve.

Nr 4-II B Boje hidroplastike importi cilesia I-re

Lyerja do te behet paraprakisht me astar cilesi e I-re dhe me pas me boje hidroplastike importi cilesi e I-re .Lyerja me boje do te behet me dy duar me rul ose pistolete. Gjate lyerjes duhet te tregohet

kujdes per mbylljen e poreve dhe sigurimin e nje siperfaqe uniforme. Lyerja do te jete e nje cilesie te larte duke parashikuar te gjitha kushtet teknike , per kete qellim dhe jane parashikuar dhe shpenzimet dhe sigurimet shoqerore te punetoreve , si dhe materjalet e nevojshme sipas normativave ne fuqi.

Nr 1- III B Ulluke shkarkimi horizontale me llamarine xingato 33cm

Ne kete çmim perfshihen materialet qe nevijiten per 1 ml ulluk horizontal,trasporti I tyre dhe puna e punetorit.Ulluket horizontale realizohen me pjeresi prej 1% per largimin e ujrave .Ulluket horizontale prodhohen me llamarine xingato me trashesi jo me te vogel se 0.8 mm, i formuar nga pjese te modeluara me mbivendosje minimale 5cm , te salduara ne menyre te rregullt me kallaj , me bord te jashtem 2 cm me te ulet se bordi i brendeshem te kompletuara me pjese speciale ne gryken e hyrjes . Ulluku horizontal i modeluar sipas udhezimeve ne projekt , duhet te jete i lidhur me tel xingato me hallka te forta te vena maksimumi ne 70 cm .

Nr 2- III B Ulluke shkarkimi vertikale me PVC φ 120 mm

Ulluket vertikale sherbejne per shkarkimin e ujrave te catise. Ne cdo ulluk duhet te mblidhen ujrat e nje siperfaqe catie ose tarrace jo me te madhe se 60 m2. Ulluket duhet te vendosen ne pjesen e jashtme te nderteses me ane te qaforeve perkatese prej celiku te xinguar , te fiksuar cdo 2 m .Ne çmim perfshihet puna e punetorit ,blerja e materialit,dhe trasporti i materialeve.



Open
Procurement
Albania